



**QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË**

**RAPORT VJETOR I AKTIVITETEVE TE  
PROGRAMIT TE KESHILLIMIT DHE  
INFORMACIONIT BUJQESOR**

**VITI 2011**

- Nr **Permbajtja**
- I **Te dhenat kryesore**
- II **Komponenti i Pare: Teknologji bashkekohore ne pentari**
1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor.
    - 1.1 Prodhimi i fidanave të ullirit me mënyra të ndryshme shartimi dhe afate kohore
    - 1.2 Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim në substrate të ndryshme rrënjëzimi
    - 1.3 Prodhimi i fidaneve të agrumeve me mënyra të ndryshme shartimi
  2. Ndikimi i ujitjes i bashkëshoqëruar me plehërimin kimik të tretshëm në ujë në prodhimin e frutave në pemëtoret intensive.
  3. Përdorimi i herbicideve në mbrojtje të kulturave drufrutore (pemë, ulli, vreshta), nga barnat e këqia.
  4. Kërkimet në fermë
  5. Akvititetet kryesore divulgative të realizuara gjatë vitit 2011
    - 5.1 Ditë fushe
    - 5.2 Biseda dhe emisione në televizion për vitin 2011
    - 5.3 Fletë palosje: 4
    - 5.4 Artukuj në gazetën “Agrobiznes” 24.
    - 5.5 Trajnime
- III **Komponenti II Ruajtja, pasurimi, administrimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor**
1. Eksplorimi, dhe studimi i resurseve autoktonë të pemëve frutore, ulli, hardhi në zonën Kucove, Skrapar, Elbasan
  2. Testimi i kultivarëve në koleksione
  3. Plotësimi i data base dhe i të dhënave të kultivarëve në koleksion
  4. Zbatimi i teknologjive në koleksione dhe parcela mëmë (pemë frutore, ulli e hardhi)
  5. Mbjellja e 4 ha ulli me kultivarin autoktonë Kalinjot
  6. Zhvillime në ullishtari në kuadër të programit të studimit të ullirit.
    - 6.1 Studimi i tipit të ullishteve
    - 6.2 Studimi i kultivarëve të mbjelle
    - 6.3 Kostot e mbjelljes
  7. Struktura dhe konkurrueshmëria e fermave të pentarise në rrethin e Vlores.
    - 7.1 Efektiviteti ekonomik
    - 7.2 Identifikimi dhe vlerësimi i fermave të përparuara në pentari
  8. Menaxhuesit e programit
  9. Bashkepunimi institucional
  10. Bazat e teknologjive të komunikimit dhe informacionit

**Pergjegjes Komponenti I Ipokrat Fiku**  
**Pergjegjes Komponenti II Athina Llambro**

**TITULLARI**  
**Dhimiter Panajoti**

## II. Komponenti I-rë: Teknologji bashkëkohore në pemtari

### 1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor.

#### 1.1 Prodhimi i fidanave të ullirit me mënyra të ndryshme shartimi dhe afate kohore

Në studim janë provuar dy kultura, ullinj dhe agrume

##### a) Shtimi i ullirit.

Janë kryer tre prova.

Prova 1: Shartimi i gjelbër në ulli.

Koha e kryerjes së shartimit: 27-28/04/2011.

Shartimi i gjelbër konsiston në marrjen e majës së gjelbër të mbishartesës dhe shartimi në filizat e n/shartesës në fazën kur është formuar çifti i parë i gjetheve të vërteta. Verifikimi i % së zënies u bë me 27/05/2011.

Prova 2: Shartimi me kalem në vijë fidanishte.

Shartimi u krye gjatë muajit prill 2011.

Prova 3: Shartimi me syth.

Shartimi u bë në fillim të muajit Maj.

Në tabelën e mëposhtme jepen të përmbledhur të gjithë treguesit e marrë në studim.

Provat e ngritura	% e zënieve	Diametri (cm)	Lartësia (cm)	Kosto/rrënjë 000/lek
Shartim i gjelber	25.3	0.49	20.5	0.084
Shartim me kalem	84	1.16	61	0.098
Shartim me syth	57.3	0.93	39.5	0.091

##### Konkluzion:

Shartimi me kalem është më i miri përse i përket edhe treguesve të dale nga studimi (% e zënies, diametrit dhe zhvillimit të fidanit).

#### 1.2 Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim në substrate të ndryshme rrënjëzimi

Studimi u ngrit me 5 prova:

Rezultatet mbi % e rrënjëzimit të copave të ullirit:

Provat	% e rrënjëzimit
Torfë 50 % + perlit 50%	20.8
Torfë 100%	9.4
Torfë 70% + perlit 30%	17.5
Gif	6.7
Perlit 100%	40.8

Si konkluzion:Në kushtet e rregjimit të përcaktuar sipas teknologjisë së prodhimit të fidanëve me nebulizim, me efektivitet më të lartë është ajo e mbjelljes së copave në substrat të pastër perliti.

### 1.3. Prodhimi i fidaneve të agrumeve me mënyra të ndryshme shartimi.

#### b) Shartimi ne agrume

Prova 1 Shartimi i gjelbër:

**Ky shartim është kryer mbi** n/shartesa ë.citrumelo dhe mbishartesa “Klementin”.

U shartuan gjithsej 150 bimë, nga 50 për çdo provë.

Prova 2 Shartimi me kalem.

Për këtë provë u kryen 90 shartime nga 30 bimë.

Prova 3 Shartimi me syth.

Ky shartim është mënyra tradicionale për shtimin e agrumeve në vendin tonë.

U shartuan 150 bimë nga 50 për çdo provë

Tabela përmbledhëse e treguesve për të tre provat e kryera.

Variantet	% e zënieve	Diametri (cm)	Lartësia (cm)	Kosto e 1 fidani (lekë)
Shartimi i gjelbër	92.6	0.67	37	84
Shartimi me kalem.	33	1.05	31.6	92
Shartimi me syth	83.3	0.67	39.5	52

Konkluzion: Shartimi i gjelbër rezulton i suksesshëm si në % e zënieve dhe në treguesit e rritjes. Me anë të këtij shartimi realizohen:

-Ngjitje dhe kontakt i plotë i indeve në pikën e shartimit,

-Mbyllje e shpejtë e plagëve, rindertimi i enëve të komunikimit dhe rigjenerimi i pikëes së shartimit.

Prodhimi i shpejtuar i bimëve të shartuara (1-1.5 vjet)

Shartimi me syth në agrume është metoda më e mirë e shtimit në agrume.

### 2. Ndikimi i ujitjes i bashkëshoqëruar me plehërimin kimik të tretshëm në ujë në prodhimin e frutave në pemëtoret intensive.

U demonstrua teknika e ujitjes me pika, bashkëshoqëruar me plehërimin në pemëtoret intensive në kulturat pjeshkë e kumbull.

### 3. Përdorimi i herbicideve në mbrojtje të kulturave drufrutore(pemë, ulli,vreshta), nga barnat e këqia.

Herbicidi : Glyphosate IPA 36 %, me 3 doza përqëndrimi

.Dëmtim i barërave të egra/m<sup>2</sup> nga Herbicidi ( Glifomark ) Glyphosate IPA 36 %

Kulturat	Provat e ngritura		
	Doza 1 % ( 3 l/ha )	Doza 1.6 % ( 5 litra/ha )	Doza 2.3 % ( 7 litra/ha )
	% e dëmtimit	% e dëmtimit	% e dëmtimit
Pemë	92.7	90	98.5
Ulli	91.6	100	100
Vreshta	69.6	95.8	98



## Konkluzione

Referuar të dhënave të kërimit përdorimi i herbicidit Glyphosate IPA 36 %, përdorur për tharjen e barërave të egra, është efektiv. Shkalla e dëmtimit të kësaj flore rritet me rritjen e përqendrimit të lëndës aktive. Tharja e kësaj mase vegetative është pothuajse e plotë duke përdorur dozën e herbicidit 1.6 %, duke mos kërkuar shtim të dozës dhe të shpenzimeve njëkohësisht.

Herbicidi i përdorur gjethe gjërat i ka dëmtuar në masën 96.7 % dhe graminacet 93.9 %. Gjykojmë se dëmtimi i barërave të egra mbi 95 % duhet të konsiderohet rezultat që ja ka arritur qëllimit.

Rivegjetimi i vrejtur dy muaj pas trajtimit tregon qartë se, për të mbajtur tokën të pastër nga barërat e egra, kërkohet më shumë se një trajtim. Por, gjithmonë, duhet të kemi parasysh impaktin që shkakëtojnë në ndotjen e ambientit përdorimi i dozave të larta dhe të përsëritura të këtyre kimikateve.

### 4. Kërkimet në fermë

Në mbështetje të kërkesave të DRBUMK nga problematika e fermerëve të zonave të ndryshme u ngritën dhe u realizuan tre projekte të kërimit në fermë. Kjo është bërë nga një punë seleksionuese e tërësisë së problemeve duke u përqendruar në problematikën me shqetësuese të fermerëve më të interesuar me të cilët ka patur një bashkëpunim të mirë komunikimi me ta.

Fermat në studim kanë përfunduar nivelin mesatar të zhvillimit të zonës.

### Projekti 1. Format optimale të krasitjes së vreshtave në kultivarët e hershëm për tryezë .

Qëllimi kryesor i studimit është përcaktimi i ngarkesës më optimale në sytha në kultivarin “Victoria”, në aspektin e rritjes së prodhimit, cilësisë së tij ( madhësisë së kokrës, uniformitetit në pjekje, fenomenit të çfaqjes së milerandimit të bistaku) dhe rjedhimisht në efektivitetin ekonomik. Ky studim u ngrit në fshatin Cerkovinë tek fermeri Vesaf Musa.

U vunë në provë :

Dëshmues me ngarkesë 12 sytha, forma kordon, sipas skemës 6 çepa x 2 sytha.

Krasitje me ngarkesë 20 sytha sipas skemës 6 çepa x 2 sytha + 1 sharmend prodhues me 8 sytha

Krasitje me ngarkesë 10 sytha sipas skemës 5 çepa x 2 sytha

**Tab 1.**

<b>Ngarkesa në bimë</b>	<b>Forma</b>	<b>Bistakë në vjelje.</b>	<b>Prodhimi gr/bimë.</b>	<b>Pesha mesat. bistakut gr.</b>	<b>Sheqeri %</b>	<b>Aciditeti gr/l</b>
<b>12 sytha</b>	6 çepa x 2 sytha	13.3	4066	301	12.4	7.8
<b>20 sytha</b>	6 çepa x 2 sytha +1 sharmend 8 sytha	20.2	5480	270	11.7	8.2
<b>10 sytha</b>	5 çepa x 2 sytha	11.8	3673	312	12.6	7.5

**Tab 2. Vrojtime për milerandimin në kokërr dhe uniformitetin e pjekjes.**

<b>Emertimi</b>	<b>Çfaqje e milerandimit në kokërr.</b>	<b>Uniformiteti në pjekje.</b>
<b>Ngarkesa 12 sytha</b>	Milerandime të pakta deri mesatare të kokrave	Pjekje uniforme e bistakut pa diferenca të theksuara
<b>Ngarkesa 20 sytha</b>	Milerandim kryesisht i theksuar në bistakët e dalë nga sharmenda e prodhimit	Uniformitet jo i kënaqshëm sidomos në bistakët e sharmendës
<b>Ngarkesa 10 sytha</b>	Milerandim i pakët	Pjekje uniforme e bistakut



### **Rekomandime:**

Mbështetur në analizën e rezultateve dhe konkluzionet e dala rekomandojmë se tek të gjithë fermeret që kultivojnë cv. "Victoria" në formën e mbajtjes së vreshtit kordon i dyanshëm, të aplikohet krasitja e sistemit të shkurtër, forma "kordon Roaja" me ngarkesë prej 12 sytha për bimë, të shpërndarë në 6 çepa në të dy anët e kordonit. Mbështetur në rezultatet e arritura, analizën ekonomike si dhe vetë cilësinë e cv. "Victoria" si një cv me pjellori të lartë edhe nga sythat bazalë, aplikimi i krasitjes me lënie të ndonjë sharmendi prodhimi do të ishte e panevojëshme, përkundër do të sillte ulje ciësore të rrushit. Nëpërmjet demonstrimeve fushore, fletë palosjeve, artikujve të ndryshëm, bisedave televizive.

Ky rekomandim u zbatua në rreth 40 % të fermereve që kanë mbjellë parcela me cv Victoria.

### **Projekti 2. Zbatimi i elementëve të veçantë teknologjikë në ullishtet intensive"**

Qellimi kryesor i kësaj prove është 'Përcaktimi i ndikimit të plehimit organomineral dhe të krasitjes në prodhimtarinë e ullishteve intensive.

Ky studim u krye në fshatin Trevllazer tek fermeri Sokol Myrto

Me anë të plehërimit ndikojmë në shumë aspekte fiziologjike të jetës gjatë ciklit jetësor.

- 1-Në futjen më herët në prodhim të ullishteve të reja
- 2-Në stabilitetin e prodhimit gjatë etapës së prodhimtarisë
- 3-Në zgjatjen e fazës së produktivitetit të bimëve



Nga përfundimet e këtij studimi u arit që zbatimi i teknologjisë së krasitjes prodhuese kombinuar me plehërimin organomineral (pleh organik 20 kg/rrenje 1 kg/rrenje N P K) ka dhënë rezultat në rreth 30 % të rritjes së prodhimit dhe në përmirësimin e cilësisë së frutit.

Rezultatet e këtij studimi u aplikua në rreth 30% të fermerëve që kultivojnë ulli.

### Projekti 3. Krasitja në kulturën e ullirit.

Qellimi i këtij kërkimi është përcaktimi i formes optimale të krasitjes së ullirit për një prodhimtari të lartë dhe cilësor te frutit.

Studimi u krye në cv. Frantoio në fshatin Cakran te rrethit te Fierit tek fermeri Bashkim Besho.



#### U provua:

1. Krasitja polikonike ( tre degë skeletore).
2. Krasitje globoze.

Nga analiza e rezultateve u arit në përfundimin se forma më e mirë e kraitjes është ajo me tre degë skeletore, pasi kjo formë lejon një ajrosje të mirë të bimës dhe lehtëson kryerjen e shërbimeve të tjera agroteknike.

Tek forma polikonike e krasitjes prodhimi rezulton me rreth 25% më shumë se tek forma globoze

#### Rekomandojme:

Aplikimin e formës së krasitjes polikonike në ullishtet me kultivarin Frantoio.

Nëpërmjet demonstrimit fushor, flete palosjes, artikujve të botuar, dhe bisedave televizive ky studim ka patur një impakt në të gjithë zonën e kultivimit të ullirit.

### 5. Akvitetet kryesore divulgative të realizuara gjatë vitit 2011

Lloji i aktivitetit	Data	Tema	Vëndi	Pjesëmarësit	Numri i pjesmares
---------------------	------	------	-------	--------------	-------------------



					<b>ve</b>
Seminar	14.2.2011	Zbatimi i hallkave teknologjike në pentari.	Q T T B Vlorë	Studentë të U.B.Tiranë	45
Seminar	2. 02. 2011	Rezultate të provave eksperimentuese me biopreparate në kulturën e ullirit.	Qarku Tirane		30
Konferencë ndërkombetare.	12. 03. 2011	Ulliri dhe vaji i ullirit.	Qarku Tiranë.	Specialistë dhe përpunues vaji	85
Work-shop	18-19.04.2011	Regjistri i vreshtave. Organizuar nga M.B. dhe TAIEX. Tirane	Qarku Tirane	Vitikultore	45
Work-shop	9-10.06. 2011	.Ngritja e rjetit virtual te informacionit dhe komunikimit per kerkimin dhe ekstensionin ne Shqiperi. (FAO)	Qarku Tirane	Specialistë t ë Q.T.T.B-ve	50
Konferencë kombëtare	30.06. 2011	Bujqesia organike	Qarku Tirane (Vorë)	Specialistë t ë Q.T.T.B-ve	70
Seminar	4.10. 2011	Teknologjia e ullirit për tryezë (bashkëp. me USAID).	Qarku Berat.	Ekstensioniste dhe fermerë	40
Seminar	10.10.2011	Vjelja e ullirit (bashkëp. me USAID).	Qarku Fier	Ekstensioniste dhe fermerë	60
Seminar	14.10.2011	Vjelja e ullirit (bashkëp. me USAID)	Qarku Vlore (Lukovë)	Ekstensioniste dhe fermerë	55

## 5.1 Ditë fushe

<b>Data</b>	<b>Tema e demonstrimit</b>	<b>Vendi</b>	<b>Pjesëmarrësit</b>	<b>Nr pjesmarrë sve</b>
25.2.2011	Luftimi syrit të palloit në ulli	Qarku Fier	Ekstensioniste. e	<b>30</b>

		(Levan)	fermere të rrethit Fier.	
4.3.2011	Konkurs, për krasitjen e ullirit "Gërshëra e artë".	Q T T B Vlorë	Me pjesëmarrje të rretheve Vlore, Berat, Fier, Tirane, Elbasan.	<b>50</b>
20.5.2011	Ngarkesa optimale në lulëri në vreshta	Qarku Durrës (Mazhe)	Fermerë të zonës	<b>25</b>
17.6.2011	Prodhimi organik në vreshta	Qarku Vlorë (Cerkovinë)	Ekstens. e fermere të rrethit Vlorë	<b>30</b>
17.6.2011	Plehrimi gjethor në hardhi.	Qarku Vlorë (Cerkovinë)	Ekstens. e fermere të rrethit Vlorë	<b>20</b>
Gjatë vitit	Për probleme të ndryshme në kulturat drufrutore	Q T T B Vlore	Studentë të U.B.Tiranë	40

### Pamje nga Aktivitet të Demonstrimit



### Vjelja e ullirit ( nentor 2011)



### Konkursi : Krasitja e ullirit "Gërshëra e artë"

### 5.2. Biseda dhe emisione në televizion per vitin 2011.


Janë zhvilluar 6 biseda televizive në mediat lokale dhe kombëtare  
 5.3 Fletë palosje: 4  
 5.4 Artukuj në gazetën “Agrobiznes” 24.

### 5.5 Trajnime

Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar 40 tema trajnime me pjesmarrje të rreth 600 personave ekstensionistë të DRBUMK dhe fermerë kultivues të dru frutoreve.

<b>Problematika e temave të zhvilluara</b>	<b>Numuri i temave</b>	<b>Numri i pjesëmarrësve</b>
Mbjellje e shërbime pas mbjelljes	11	160
Mbrojtje fitosanitare e përdorim herbicidi	8	90
Krasitje	6	75
Teknologji intensive	4	75
Menaxhim ferme	4	70
Fidanishte-prodhim fidana	4	65
Vjelje e ruajtje fruta, cilësi vaji	2	40
Resurse gjenetike	1	25

## HARTA E SHPERNDARJES SE AKTIVITETEVE DIVULGATIVE 2011



**III. Komponenti II- të. Ruajta, pasurimi, administrimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor**

Puna kryesore e këtij komponenti përfshin resurset gjenetike të vendit e të huaja të mbjellë në gjithë sipërfaqen e Shamogjinit si dhe menaxhimin e detyrave të dala nga studimi i ullirit.

Baza e Q.T.T.B ka një sipërfaqe prej 57 ha në të cilën janë mbjellë një numër i madh i resurseve gjenetike të pemëve frutore, ulli, hardhi, agrume.

Në këtë qendër ndodhen:

Në pemë frutore 146 kultivarë të huaj me rreth 20 specie.

Në hardhi 57 kultivarë të vendit dhe 86 kultivarë të huaj.

Në ulli 22 kultivarë të vendit dhe 30 kultivarë të huaj

Në agrume rreth 12 kultivarë.

### **1. Eksplorimi, dhe studimi i resurseve autoktonë të pemëve frutore, ulli, hardhi në zonën Kucove, Skrapar, Elbasan.**

Në vitin 2011 janë identifikuar 8 aksesioneve të pemëve frutore, 4 aksesione të hardhisë dhe 3 aksesione ulliri. Të gjithë aksesionet e grumbulluar do të shfrytëzohen për punën gjenetike seleksionuese dhe aksesionet me vlera të larta për shtim në zonat e përshtatshme.

Në bezen e Shamogjinit egzistojnë :

Koleksioni i pemëve frutore autoktone me një sipërfaqe prej 1 ha me rreth 17 specie dhe 120 aksesione.

Koleksioni autokton i hardhisë me sipërfaqe 2.4 ha me 5 kultivarë rrushi (Shesh i bardhë, Shesh i zi, Debinë e bardhë, Kallmet dhe Vlosh).

Koleksioni i ullirit me sipërfaqe 1.2 ha me 22 kultivarë.

Ndërkohë në repozitorin pranë Q T T B në vazo ndodhen të gatshëm për tu mbjellë në vendin e përhershëm rreth 50 aksesione të pemëve frutore, ulli, e hardhi.

### **2. Testimi i kultivarëve në koleksione**

Vlerësimi agro-biologjik i kultivarëve në koleksionin e pemëve frutore. Studimi i sjelljes së kultivarëve në kushtet e zonës ku janë mbjellë.

Koleksioni i pemëve frutore i mbjellë në Shamogjin ka si qëllim për të testuar përshtatshmërinë e këtyre kultivarëve në kushtet e zonës ku janë mbjellë. Në studim janë:

#### **a) Pemë frutore**

Bajame, dhe fruta të vegjël

Për kulturën e Bajames u studjuan 7 kultivarë të mbjellë në koleksionin e pemëve frutore

Ferragnes, Filippo Geo, Genco, Pepparuda, Supernova, Teksas, dhe Tuono.

Kultivarët më të përshtatshëm për zonën e Vlorës janë Ferragnes, Genco, Pepparuda, Supernova.

#### **b) Ulli**

(kultivarë të huaj italian në koleksion për prodhim vaji)

Janë marë në studim kultivarët Passola, Moraiolo, Toscanina, Picholin, Ascolana, Gordales, Noccelare del Bellice, Nociara, Cima di Melfi, Nolca.

Kultivarët më të përshtatshëm për zonën e Vlorës janë: Passola, Moraiolo, Nociara, Nolca.

#### **c) Në hardhi**

(kultivarët për verë të kuqe koleksion)

Shesh i Zi, Vlosh, Kallmet, Merlot, Kotek e Zezë, Debinë e Zezë, Tajgë e Zezë, Sangivese, Kabernet Sovinjo, Alikant Bushe

Kultivarët më të përshtatshëm për zonën e Vlorës janë: Shesh i Zi, Vlosh, Kallmet, Merlot, Sangiovese, Kabernet Sovignon.

### 3. Plotësimi i data base dhe i të\ dhënave të\ kultivarëve në koleksion

Eshtë plotësuar data baza e të dhënave të pemëve frutore autoktone, hardhisë dhe ullirit.

Ky informacion gjëndet në faqen e internetit : [www.Eurisco.al](http://www.Eurisco.al)

### 4. Zbatimi i teknologjive në koleksione dhe parcela mëmë (pemë frutore, ulli e hardhi)

**Baza eskperimentale/prodhuese Shamogjin.** është qenda e ruajtjes së germoplasmës të vendit e të huaj dhe e zbatimit të teknologjive bashkëkohore. Këtu gjëndet një pasuri varietore në pemë frutore, ulli, agrume e hardhi të mbjella në koleksione

Menaxhimi i tokës është element i rëndësishëm në këtë bazë.

Në një pjesë të sipërfaqes së tokës përdoret herbicidi (në rresht dhe në skarpatat e tarracave). Në mes të rreshtave lihet tapet bari i cili kositet shpesh.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së mbjellë është nën ujë. Këtu përdoret ujitja me pika e cila ka një efijencë më të madhe krahasuar me sistemet e tjera të ujitjes. Në rreth 12 ha është shtirë impianti i ujitjes me pika. Nunri i ujitjeve arin dhe 8.-10 ujitje në kodër tek agrumet.

Gjithashtu përdorimi i ujitjes me plehërim përfaqëson një faktor kyç. Përdorimi i plehrave në ujitje ka dhënë rezultate në zhvillimin e kurorave të pemëve deri në 30% më shumë.

Mbrojtja fito sanitare është e përqëndruar në dy momente kryesore: monitorim dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në gjitha kulturat e mbjella.

Kombinimi i luftës së integruar me ate biologjike është objektivi kryesor për mbrojtjen e bimeve në parcelat mëmë dhe koleksione.

Elementë të tjerë të rëndësishëm në këtë territor janë pemtoret mëmë të drufrutorëve bërthamore, të ullirit dhe hardhisë autoktone, të cilat shërbejnë për marrjen e materialit për shtim

Q T T B Vlorë prodhon material të kategorive të larta ( pemë frutore, ulli e hardhi) për fidanishtet.

Nga pemtoret mëmë të ullirit ne jo vetëm plotësojmë nevojat tona me rreth 150.000 lastarë për prodhimin e fidanëve të ullirit me nebulizim në serrë por dhe kërkesat e fermerëve të zonës



**KOLEKSIONI I PËMEVE  
FRUTURE**



**KOLEKSIONI I ULLIRIT**



**KOLEKSIONI AUTOKTON I  
HARDHISË**



**PARCELA PËR COPA  
VEGJETATIVE**

## LEGJENDA

1. Serra e fidanave të ullirit me nebulizim.
2. Fushat e rritjes së ullirit
3. Parcelëmëmë ulli
4. Koleksion agrume
5. Fidanishte ulliri
6. Parcelë mëmë bajame
7. Ulli autokton
8. Pentore mëmë dardhë
9. Pentore mëmë qershë
10. Pentore mëmë kajsi
11. Pentore mëmë pjeshkë
12. Parcela e farës pemë frutore
13. Parcela për copa vegetative pemë frutore
14. Pentore intensive pemë frutore
15. Koleksion autokton pemë frutore
16. Koleksioni i ullirit.

## VENDOSJA E PARCELAVE NE BAZEN EKSPERIMENTALE SHAMOGJIN



### 5. Mbjellja e 4 ha ulli me kultivarin autoktonë Kalinjot,

Në bazen eksperimentale Shamogjin u mboll një sipërfaqe prej 4 ha me ullishte mëmë me kultivarin Kalinjot e cila do të shërbejë për marrjen e materialin mbjellës (kalema) për shtimin e ullirit me nebulizim.

### 6. Zhvillime në ullishtari në kuadër të programit të studimit të ullirit.



### 6.1: Studimi i tipit të ullishteve

Për të identifikuar tendencën e zhvillimit të ullishtarisë gjatë vitit 2011 janë evidentuar tipet e ullishteve. Janë verifikuar 4 tipe: Ullishte tradicionale (deri 250 bimë/ha), ullishte të zakonshme (250 - 350 bimë/ha), ullishte intensive (350 - 500 bimë/ha) dhe ullishte superintensive (mbi 1000 bimë/ha). Nga të dhënat e studiuara rezulton se në mbjelljet e këtij viti rreth 84.7 % e sipërfaqes janë ullishte e zakonshme dhe intensive.

#### Tipi i ullishteve të mbjella në vitin 2011

Tipi i ullishtes	Gjithsej ha mbjellë 2011	% e çdo tipi ndaj totalit ha
Ullishte tradicionale deri 250 bimë/ha	420.61	13.6
Ullishte të zakonshme 250-350 bimë/ha	2027.39	65.5
Ullishte intensive 350-500 bimë/ha	594.51	19.2
Ullishte superintensive mbi 1000 bimë/ha	51.4	1.7
<b>Totali</b>	<b>3093.91</b>	<b>100</b>

Vrehet gjithashtu mbjellja e ullishteve superintensive, që në vitin 2011 zë 1.7 % të sipërfaqes totale. Për këtë tip ullishte është përdorur varieteti Arbequina, përqëndruar kryesisht në qarkun e Fierit. Duhet theksuar se gjatë këtij viti janë mbjellë 3094 ha ose 17.2 % më shumë se në vitin 2010. Investimi i fermerit në mbjelljet e ullirit të vitit 2011 zë 25.4 % të investimeve totale për qarqet e studiuara, një fenomen mjaft pozitiv për të ardhmen e zhvillimit të ullishtarisë.

### 6.2. Studimi i kultivarëve të mbjellë

Mbas përpunimit të të dhënave të grumbulluara nga qarqet rezulton se në vitin 2011 janë mbjellë gjithsej 17 kultivarë ulliri, nga të cilët 10 kultivarë autokton dhe 7 të huaj.

#### KULTIVARË AUTOKTON

Kultivarët	Numri i Rrënjëve Mbjele 2011	Sipërfaqe ha Mbjele 2011
<b>I. Për vaj</b>		
Kalinjot	51225	194
Ulliri Bardhë i Tiranës	12947	27.6
Ulliri Zi i Tiranës	1150	1.2
Mixan	41350	128.9
Frëngu	100	0.4
Boç	1800	4.3
Ulliri Bardhë i Krujes	2551	7.3
Nisiot	2700	12.2
Kallmet		
Kushan		
Ulliri Hollë i Himarës		

Kotruvs		
<b>Shuma</b>	<b>113823</b>	<b>375.8</b>
<b>II. Për tryezë</b>		
Kokërr Madh Elbasani		
Kokërr Madh Berati	65140	280.5
Krypsi i Krujës	358	1.1
<b>Shuma</b>	<b>65498</b>	<b>281.6</b>
<b>Totali</b>	<b>179321</b>	<b>657.4</b>

Nga kultivarët autokton: Për vaj janë mbjellë 8 kultivarë dhe për tryezë 2. Sipërfaqe më të mëdha janë mbjellë : për vaj me : Kalinjot dhe Mixan, ndërsa për tryezë me : Kokër Madhin e Beratit. Fermerët, sipas zonave, kanë respektuar traditën, duke preferuar kultivarë të përshtatur plotësisht në kushtet e zonës. Kultivarët autokton janë mbjellë me 273 bimë/ha : ata për tryezë me 234 bimë/ha dhe për vaj me 303 bimë/ha.

#### KULTIVARË TË HUAJ

Kultivarët	Numri i Rrënjëve Mbjellë 2011	Sipërfaqe ha Mbjellë 2011
<b>I. Për vaj</b>		
Frantoio	618826	2013.72
Leccino	103188	291.99
Koroneiki	17661	46.03
Coratina	2684	5.39
Arbequina	44018	51.4
Carolea		
Bianchera		
<b>Shuma</b>	<b>786377</b>	<b>2408.53</b>
<b>II. Për tryezë</b>		
Kalkidiki	6142	12.93
Kallamon	3895	14.94
Manzanilla		
Nocellara del Belice		
Konservolia		
<b>Shuma</b>	<b>10037</b>	<b>27.87</b>
<b>Totali</b>	<b>796414</b>	<b>2436.4</b>

Ndërsa nga kultivarët e huaj: Për vaj janë mbjellë 5 dhe për tryezë 2 kultivarë. Kultivarët më të preferuar në këtë kategori janë: për vaj: Frantoio dhe Leccino dhe për tryezë: Kalkidiki dhe Kallamon.

Për kultivarët e huaj është preferuar të mbillet me 327 bimë/ha, nga e cila : ata për vaj me 326 bimë/ha dhe për tryezë me 357 bimë/ha.

Në totalin e sipërfaqes së mbjellë gjithsej gjatë vitit 2011 kultivarët autokton zënë 21.2 % dhe ata të huaj 78.8 %.

### 6.3. Kostot e mbjelljes

Në përlogaritjen e kostos së mbjelljes janë përfshirë tipet më përfaqësuese të ullishteve. Shpenzimet e mbjelljes për 1 ha ulli janë shifra orientuese që do t'i shërbejnë fermerit për llogaritjen e investimeve për tipe të ndryshme ullishtesh.

Nga të dhënat e studiuara, krahasuar me ullishten tradicionale, ka rritje të shpenzimeve përkatësisht: në ullishtet e zakonshme 19 %, në ato intensive 30.1 % dhe në ullishtet superintensive 85.8 %. Përqindjen më të madhe të shpenzimeve, në totalin e tyre, e zënë shpenzimet mekanike dhe ato materiale.

Struktura e shpenzimeve të zërave të kostos për punën e krahut, për të gjitha tipet e ullishteve, është e pothuajse e përafërt.

Kosto sipas tipit të ullishteve

Tek punimet me mekanikë përqindje më e lartë shpenzimesh vrehet tek zëri hapje brezaresh.

Tipi ullishteve	Njësia	Gjithsej Leke/ha	Punime Me krah leke	Punime me Mekanikë leke	Materiale leke
Ullishte tradicionale 250 bime/ha	leke	744300	17000	495500	360400
Ullishte të zakonshme 330 bimë/ha		885800	30900	494500	360400
Ullishte intensive 450 bimë/ha		968400	40500	500500	427400

Ndërsa tek zëri materiale përqindje më të lartë në shpenzimet totale zënë nënzërat: fidanë ulliri dhe pleh organik.

**Fermeri duhet të ketë parasysh këtë analizë për të kursyer investimet e tij, kryesisht në zërat që zënë peshën më të madhe në strukturën e kostos së mbjelljes së ullirit.**

## 7. Struktura dhe konkurrueshmëria e fermave të pemtarisë në rrethin e Vlores.

### 7.1. Efektiviteti ekonomik

Lidhur me efektivitetin e fermës studimi është kryer në 71 ferma pemtarie në rrethin e Vlorës dhe 36 ferma të prodhimit të fidanëve frutorë në qarqet: Vlorë, Fier, Durrës, Tiranë.

Karakteristika të fermës në rrethin e Vlores:

**Sipërfaqja e mbjelle me pemtari ze 67.9% të sipërfaqes në pronësi. Sipërfaqja në pronësi është 1.9 ha / ferme dhe e mbjelle me frutikulture 1.3 ha/fermë.**

**Në sipërfaqen e mbjelle me drufrutore pemtari frutore zënë 28.2 % ulliri 35.6% dhe vreshti 33.7%.**

**Mbizoteron tipi i fermes me vreshtari dhe ullishtari + vreshtari. Toka e kultivuar me pentari shtrihet pergjithsisht ne fushe dhe ne koder. Ne te ardhurat gjithsejt te fermes pentaria ze 82.5% dhe aktivitetet ndihmese ( bujqesi+ blegtori) 17.5%.**

**Në të ardhurat nga pentaria, vreshtaria zë 64.6%, ndërsa në të ardhurat nga aktivitet ndihmëse mbizotëron blegtoria me 72%.**

Nga studimi i treguesve: e të ardhurave gjithsej të fermës, të ardhurat nga aktivitetet ndihmëse dhe aktiviteti kryesor, të ardhurat për fermë, të ardhurat për ha dhe të ardhurat për fryme, janë përcaktuar në mënyrë orientuese drejtimet më efikase të strukturës menaxhuese të fermës së pentarisë, në zona të ndryshme të ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Nga përpunimi i të dhënave për treguesit e mësipërm rezulton se strukturat menaxhuese më efikase të fermës do të ishin:

**Për zonën e ulët dhe bregdetare (deri 150 mbi nivelin e detit):**




1.Ullishtari + Vreshtari; 2.Vreshtari; 3.Pemtari + Prodhim Fidanësh; 4.Vreshtari + Prodhim fidana.

**Për zonën qendrore (150 - 250 m mbi nivelin e detit):** 1.Vreshtari + Bujqësi + Blegtori

**Për zonën malore (250 - 400 m mbi nivelin e detit):**

1.Vreshtari + Blegtori,

2. Pentari + Ullishtari + Vreshtari



Të dhënat janë orientuese për fermerët që kërkojnë të nisin apo të zhvillojnë më me efikasitet një aktivitet prodhimi sipas zonave.

Për të qënë një orientim i mirë përcaktuar kërkohet të thellohemi në studimin e këtyre treguesve dhe tregues të tjerë të aktivitetit të fermës, gjë që do të bëhet në vitet në vazhdim.

**Demonstrimi i rezultateve te këtij studimi eshte realizuar nepermjet zhvillimit te temave te trajnimit dhe takimeve me fermere e ekstensioniste ne disa qarqe te vendit.**

## 7.2. Identifikimi dhe vlerësimi i fermave te përparuara ne pentari.

Në shkallë vendi kemi rreth 156.000 ferma pentarie dhe rreth 80 ferma që prodhojnë fidana frutore. Në shumë prej tyre zhvillimi është mjaft intensiv dhe efikas. Produktet e prodhuara nga këto ferma po konkurrojnë denjësisht edhe në tregun e jashtëm.

Meqëse sektori i pentarisë në Shqipëri është një prioritet strategjik në zhvillimin e bujqësisë, është kryer studimi i mësipërm me qëllim bashkëpunimi me Q T T B Vlore per zbatim e teknologjive te

përparuara në këto ferma dhe pasqyrimin e rezultateve të prodhimit në shërbim të fermave të ngjashme në shkallë vendi.

### Krijimi i Data Baze për fermat e mësipërme.

Rrethi	Ferma Gjithsej	Pemtari	Ullishte	Vresht	Agrume
Berat	7	3	1	1	2
Kuçovë	5	2	3		
<b>Q. Berat</b>	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>2</b>
<b>Q. Durrës</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	
Elbasan	12	3	7	2	
Peqin	1		1		
<b>Q. Elbasan</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	
Fier	21	6	4	10	1
Lushnje	10	5	1	4	
Mallakastër	5		3	2	
<b>Q. Fier</b>	<b>36</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>16</b>	<b>1</b>
Gjirokastër	3			3	
Përmet	3	1		2	
Tepelenë	4		2	2	
<b>Q. Gjirokastër</b>	<b>10</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	
Lezhë	6		2	4	
Kurbin	2		1	1	
<b>Q. Lezhë</b>	<b>8</b>		<b>3</b>	<b>5</b>	
M. e Madhe	3	1		2	
Shkodër	7	1	2	3	1
<b>Q. Shkodër</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>1</b>
Tiranë	7	1		6	
Kavajë	7	3		4	
<b>Q. Tiranë</b>	<b>14</b>	<b>4</b>		<b>10</b>	
<b>Q. Vlorë</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>2</b>		<b>1</b>
<b>TOTALI</b>	<b>114</b>	<b>35</b>	<b>28</b>	<b>46</b>	<b>5</b>

Në numrin total të këtyre fermave grup fermat zënë 7% dhe 36 % të sipërfaqes gjithsej të fermave. Më shumë grup ferma janë organizuar në qarkun e Fierit. Përgjithsisht mbizotëzojnë ato që kultivojnë vreshta e ullishte. Në këtë drejtim janë evidentuar dhe është bashkëpunuar për promovimin e teknologjive të përparuara edhe me shoqatat: e fermerëve të ullirit në Vlorë, CEFA në Elbasan, Shoqata e ullirit Fier etje. Kemi bashkëpunuar dhe ndihmuar me zgjidhje problematikash dhe përmirësim teknologjish në grupfermën me agrume në Xarë dhe Mursi në Sarandë.

Është punuar në publikimin e rezultateve konkrete të kësaj tip ferme me qëllim sensibilizimn e fermerëve për krijim strukturash të reja menaxhimi, për rritjen e efektivitetit ekonomik të fermës në terësi dhe përmirësimin e cilësisë së produktit sipas kërkesave të konsumatorit dhe tregut.

## 8. Menaxhuesit e programit

Nr	Menaxhuesit	Funksioni	Kultura
1	Ipokrat Fiku	Pergjegjes i sektorit te Teknologjive ( Agronom)	Hardhi
2	Athina Llambro	Pergjegjes sektorit menaxhimit te Resurseve gjenetike ( Agronom)	Peme frutore autoktone
3	Dhimiter Panajoti	Drejtor ( Agronom)	Ulliri
4	Zaim Veshaj	Pergjegjes Departamenti (( Agronom)	Peme frutore
5	Jaho Nelaj	Specialist ( Agronom)	Agrumet
6	Lida Lazaj	Specialiste ( Agronom)	Pradhimi i fidaneve
7	Enver Braho	Specialist ( Agronom)	Analiza dhe Modelim Ferme
8	Lumturi Xhelilaj	Specialiste ( Ekonomist)	Analiza dhe Modelim Ferme
9	Luljeta Malaj	Specialiste ( Ekonomist)	Analiza dhe Modelim Ferme
10	Aulona Veizi	Specialiste Laboratori	Prodhimin e vajit
11	Elektra Spahiu	Specialiste Laboratori	Analiza kimike
12	Nikoleta Mone	Specialiste Laboratori kimik	Analiza kimike
13	Ramo Merkohitaj	Specialiste ( Agronom)	Bazat
14	Adhurim Lazaj	Specialiste ( Agronom)	Serra e Prodhimit te Fidanave

## 9. Bashkepunimi me institucionet

Ne raport eshte pershkruar nje bashkepunim efikas me USAID-AAC ne baze te nje memorandumi me MBUMK, ne fushen e transferimit te teknologjive. Jane kryer shume trajnime dhe seminare, ku nder me te rendesishmit eshte Konferenca e Vajit te Ullirit ne mars 2011. Eshte dhene nje kontribut i rendesishem teknik ne Komunen Xare - Mursi per zhvillimin e Klementinave ne kete zone, perfshire dhe nje udhetim per shkembim eksperience ne Kalabri. Per agrumikulturen USAID po financon publikime divulgative.

Kemi nje bashkepunim konstant me UBT ne sektorin e ullishtarise ne fushen e mbrojtjes se bimeve, te fidanishtes se ullirit dhe te germoplasmes.

Kemi realizuar nje bashkepunim efektiv me IBB ne ullishtari, me prodhimin organik te ullirit, certifikimin ne fushe dhe perpunim dhe nxjerrjen e produktit vaj organik nga parcelat tona.

Parashikojme qe bashkepunimi te shtrihet edhe ne vreshtarine me kultivare autoktone.

Me CNR IVALSA, CRA- Rome, vazhdojme te kemi shkembime teknike dhe transferim teknologjie per ullirin dhe shumezimin e materialit bimor.

## 10 Bazat e teknologjive te komunikimit dhe informacionit

Q T T B eshte perfshire ne nje projekt UNJP/006/ALB/UNJ mbi forcimin e lidhjeve funksionale dhe ndertimi i kapacitetve midis aktoreve te kerkimit shkencor kombetar dhe sistemeve te ekstensionit per ti siguruar sherbime efektive fermerëve ne te gjithe Shqiperine.

Q T T B Vlore brenra ketij rrjeti ka faqen e saj zyrtare me nje srukture te percaktuar

Nga Q T T B Vlore eshte futur nje pjese e informacinit dhe ai freskohet sipas problematikes se kohes.

Keto informacione mund te gjeni ne adresen [www.agro.al/typo3](http://www.agro.al/typo3) ; [www.mbumk.gov.al](http://www.mbumk.gov.al)



